



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.12.2021

**MBLEDHJA Nr. 59,
datë 21.12.2021, ora 12:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 21.12.2021, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 59 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi lënien në fuqi të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 212, nr. 213 dhe nr. 214, datë 15.12.2020
2. Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 20.01.2021 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do tu paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021”
3. Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2022
4. Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a. për rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020
5. Mbi miratimin e Licencës TIP për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së
6. Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
7. Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjise elektrike
8. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kamican” me kapacitet të instaluar 1860 kW

9. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW
10. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për tranferimin e asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.
12. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI